

31987L0344

Direktivë e Këshillit 87/344/EEC, datë 22 qershor 1987, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e shpenzimeve ligjore

Gazeta Zyrtare L 185, 04/07/1987 fq. 0077 - 0080

Botim i posaçëm në gjuhën finlandez e kapitulli, 6 volumi 2 fq. 0161

Botimi i i posaçëm në gjuhën suedeze kapitulli 6 volumi 2 fq. 0161

Direktivë e Këshillit datë 22 qershor 1987, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e shpenzimeve ligjore (87/344/KEE)

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European dhe në veçanti nenin 57 paragrafi 2 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke marrë parasysh opinionin e Parlamentit European [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [3],

Meqë Direktiva e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës [4], e ndryshuar për herë të fundit me Direktivën 87/343/KEE[5], eliminoi disa dallime të caktuara ekzistuese ndërmjet legjislacioneve kombëtare me qëllim lehtësimin e fillimit dhe ndjekjes së këtyre veprimtarive;

Meqë, nga ana tjetër, neni 7 pika 2 germa “c” i Direktivës 73/329/KEE parashikon që “në pritje të bashkërendimit të mëtejshëm, i cili duhet të zbatohet brenda katër vjetëve nga njoftimi i direktivës, Republika Federale Gjermane mund të mbajë në fuqi dispozitën që ndalon ndërmarrjen në territorin e saj njëkohësisht të sigurimit shëndetësor, sigurimit të kredisë dhe dorëzansisë ose sigurimit ndaj palëve të treta dhe të mbrojtjes ligjore, me njeri-tjetrin ose me klasa të tjera”;

Meqë kjo direktivë parashikon bashkërendimin e sigurimit të shpenzimeve ligjore sipas parashikimit të nenit 7 pika 2 germa “c” të Direktivës 73/239/KEE;

Meqë, për të mbrojtur personat e siguar, është mirë të merren hapat për të parandaluar, aq sa është mundur, çdo konflikt interesi ndërmjet një personi me mbulim të shpenzimeve ligjore dhe siguresit të tij, që rrjedh nga fakti, që ky i fundit e mbulon atë në lidhje me një

klasë tjetër të sigurimit të përmendur në Shtojcën e Direktivës 73/239/KEE ose mbulon një person tjetër dhe, nëse lind një konflikt i tillë, të mundësohet zgjidhja;

Meqë është mirë të përjashtohet nga fushëveprimi i kësaj direktive sigurimi i shpenzimeve ligjore në lidhje me mosmarrëveshjet ose risqet që rrjedhin nga përdorimi i mjeteve lundruese detare ose në lidhje me përdorimin e mjeteve lundruese detare, duke pasur parasysh natyrën specifike të këtij përdorimi;

Meqë, po ashtu, nga fusha e veprimit e kësaj direktive është mirë që të përjashtohet edhe veprimtaria e siguresit që ofron shërbime ose merr përsipër shpenzimet e mbrojtjes të personit të siguar në lidhje me një kontratë me përgjegjësi civile, nëse kjo veprimtari ndiqet, për interesin e vet siguresit, për këtë mbulim sigurimi;

Meqë është mirë që Shteteve Anëtare t'u lihet në dorë mundësia e përjashtimit nga fusha e veprimit e kësaj direktive i veprimtarisë së sigurimit të shpenzimeve ligjore të marra përsipër nga një sigures i ndihmës nëse ky aktivitet zhvillohet në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga ai në të cilin personi i siguar ka vendqëndrimin e përhershëm ose nëse kjo është pjesë e një kontrate që mbulon vetëm ndihmën e dhënë personave të cilët bien në vështirësi gjatë udhëtimit ose kur janë larg banesës ose larg vendqëndrimit të përhershëm.

Meqë sistemi i specializimit të detyruar që zbatohet tashmë nga një Shtet Anëtar, siç është Republika Federale Gjermane, parandalon pjesën më të madhe të konflikteve; meqë, nga ana tjetër, nuk del e nevojshme zgjerimi i këtij sistemi në të gjithë Komunitetin për të përftuar këtë rezultat, gjë që do të kërkonte ndarjen e ndërmarrjeve mikse;

Meqë rezultati i dëshiruar mund të arrihet duke u kërkuar ndërmarrjeve të parashikojnë një kontratë të veçantë ose një rubrikë të veçantë të një police të vetme për sigurimin e shpenzimeve ligjore dhe duke i detyruar ato të kenë administrim të veçantë për sigurimin e shpenzimeve ligjore ose t'ia ngarkojnë administrimin e kërkesave për dëmshpërblim në lidhje me sigurimin e shpenzimeve ligjore një ndërmarrjeje që ka personalitet të veçantë juridik ose t'i japin personit që ka mbulim me siguri të shpenzimeve ligjore të drejtën ta zgjedhë vetë avokatin e tij nga momenti që ka të drejtën të kërkojë dëmshpërblim nga siguresi;

Meqë, cilado zgjidhje të zbatohet, interesi i personave që kanë mbulim me siguri për shpenzimet ligjore mbrohet me masa mbrojtëse të barasvlershme;

Meqë interesi i personit që ka mbulim me siguri për shpenzimet ligjore është që personi i siguar të jetë në gjendje të zgjedhë një avokat ose një person tjetër të kualifikuar si duhet në përputhje me legjislacionin kombëtar në çdo proces administrativ ose gjyqësor dhe kurdoherë që lind një konflikt interesi;

Meqë është mirë që Shteteve Anëtare t'u lihet mundësia e përjashtimit të ndërmarrjeve nga detyrimi për t'i lënë personit të siguar zgjedhje të lirë të avokatit nëse siguri i shpenzimeve ligjore lejohet vetëm për çështjet që lindin nga përdorimi i mjeteve lëvizëse rrugore në territorin e tyre ose nëse përmbushen kushte të tjera kufizuese;

Meqë, nëse lind një konflikt ndërmjet siguruesit dhe të siguruarit, është e rëndësishme që të zgjidhet sa më drejt dhe shpejt; meqë është e përshtatshme që të parashikohet në policat e sigurimit të shpenzimeve ligjore një procedurë arbitrazhi ose një procedurë që ofron garanci të ngjashme;

Meqë paragrafi i dytë i pikës C të Shtojcës së Direktivës 73/239/KEE parashikon që risqet e përfshira në klasat 14 dhe 15 në pikën A nuk mund të konsiderohen si risqe ndihmëse për klasat e tjera; meqë ndërmarrja e sigurimeve nuk duhet të lejohet të mbulojë shpenzime ligjore si risk shtesë krahas një risku tjetër pa marrë autorizimin në lidhje me riskun e shpenzimeve ligjore; meqë, nga ana tjetër, është mirë t'u lihet Shteteve Anëtare mundësia ta konsiderojnë klasën 17 si një risk shtesë të lidhur me klasën 18 në raste specifike; meqë, nga ana tjetër, pika C e kësaj shtojce duhet të ndryshohet përkatësisht,

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË

Neni 1

Qëllimi i kësaj direktive është bashkërendimi i dispozitave të parashikuara me akte ligjore, nënligjore ose administrative në lidhje me sigurimin e shpenzimeve ligjore të përmendura në pikën 17 të pikës A të Shtojcës së Direktivës së Këshillit 73/239/KEE me qëllim që të lehtësohet ushtrimi i efektshëm i lirisë së vendosjes dhe të parandalohet për aq sa është e mundur çdo konflikt interesi që lind veçanërisht nga fakti që siguruesi mbulon një person tjetër ose mbulon një person në lidhje me shpenzimet ligjore dhe me një klasë tjetër të shtojcës së lartpërmendur dhe nëse lind një konflikt i tillë, të mundësohet zgjidhja e tij.

Neni 2

1. Kjo direktivë zbatohet për sigurimin e shpenzimeve ligjore. Kjo konsiston në marrjen përsipër të mbulimit të kostos së procedurave gjyqësore dhe dhënies së shërbimeve të tjera të lidhura drejtpërdrejt me mbulimin me sigurim, kundrejt pagesës së një primi, veçanërisht në lidhje me:

- kompensimin për humbjen, dëmin ose dëmtimin e pësuar nga personi i siguar, nga zgjidhjet jashtëgjyqësore ose gjatë proceseve civile ose penale,
- mbrojtjen ose përfaqësimin e personit të siguar në proceset civile, penale, administrative ose të tjera në lidhje me çdo pretendim të ngritur ndaj tij.

2. Megjithatë, kjo direktivë nuk zbatohet për:

- sigurimet për shpenzimet ligjore nëse këto sigurime kanë të bëjnë me mosmarrëveshje ose risqe që rrjedhin nga përdorimi i mjeteve të lundrimit ose në lidhje me përdorimin e mjeteve të lundrimit detare,
- veprimtarinë e zhvilluar nga siguruesi që ofron mbulim sigurimi për përgjegjësinë civile për qëllimin e mbrojtjes ose përfaqësimit të personit të siguar në çdo procedim administrativ ose gjyqësor nëse kjo veprimtari ndiqet në të njëjtën kohë edhe në interes të vetë siguruesit nën të njëjtin mbulim,

- veprimtarinë e sigurimit të shpenzimeve ligjore të ndërmarrë nga një sigurues ndihmës nëse kjo veprimtari ushtrohet në një Shtet Anëtar që nuk është Shteti Anëtar ku ka vendqëndrimin e përhershëm personi i siguruar, kur kjo është pjesë e një kontrate që mbulon vetëm ndihmën e dhënë personave të cilët bien në vështirësi gjatë udhëtimit ose kur janë larg banesës ose larg vendbanimit të tyre të përhershëm, nëse vendos Shteti Anëtar. Në këtë rast, kontrata duhet të shprehë qartë që mbulimi në fjalë është i kufizuar në rrethanat e përmendura në fjalinë e mësipërme dhe është shtesë për ndihmën.

Neni 3

1. Mbulimi i shpenzimeve ligjore është objekt i një kontrate më vete nga kontrata e hartuar për klasat e tjera të sigurimeve ose trajtohet në një rubrikë të veçantë të një police të vetme në të cilën përcaktohet natyra e mbulimit të shpenzimeve ligjore dhe, nëse këtë e parashikon Shteti Anëtar, shuma e primit përkatës.

2. Çdo Shtet Anëtar merr masat e nevojshme për të siguruar që ndërmarrjet e vendosura në territorin e tij të zbatohen, sipas mundësive të lejuara nga Shteti Anëtar, dhe, nëse Shteti Anëtar bie dakord, sipas zgjedhjes së tyre, të paktën një nga zgjidhjet e mëposhtme, të cilat janë alternativa:

(a) ndërmarrja siguron që asnjë punonjës i angazhuar në administrimin e kërkesave për dëmshpërblim për shpenzimet gjyqësore ose në këshillimin ligjor në lidhje me to të mos ushtrojë njëkohësisht një veprimtari të ngjashme:

- nëse ndërmarrja është mikse, për një klasë tjetër që ofrohet prej saj,

- në një ndërmarrje tjetër që ka lidhje financiare, tregtare ose administrative me të parën dhe që ofron një ose disa prej klasave të sigurimeve që parashikohen në Direktivën 73/239/KEE, pavarësisht nëse ndërmarrja është mikse ose e specializuar;

(b) ndërmarrja ia ngarkon administrimin e kërkesave për dëmshpërblim në lidhje me sigurimin e shpenzimeve ligjore një ndërmarrjeje që ka personalitet të veçantë juridik. Kjo ndërmarrje përmendet në kontratën e veçantë ose në rubrikën e veçantë të përmendur në pikën 1. Nëse ndërmarrja që ka personalitet të veçantë juridik ka lidhje me një ndërmarrje që ofron një ose më shumë nga klasat e tjera të sigurimit të përmendura në pikën A të Shtojës të Direktivës 73/239/KEE, punonjësit e ndërmarrjes të cilët janë përfshirë në trajtimin e kërkesave për dëshpërblim ose këshillimin ligjor në lidhje me këtë trajtim nuk mund të ndjekin të njëjtën veprimtari apo një veprimtari të ngjashme në një ndërmarrje tjetër njëkohësisht. Përveç kësaj, Shtetet Anëtare mund të vendosin të njëjtat kërkesa për anëtarët e organit administrativ;

(c) ndërmarrja parashikon në kontratë të drejtën e personit të siguruar për t'ia caktuar mbrojtjen e interesave të tij, nga momenti që ai ka të drejtën të ngrejë pretendim kundrejt siguruesit të tij sipas policës, një avokati të zgjedhjes së tij ose, nëse legjislacioni kombëtar e lejon, një personi tjetër të kualifikuar sipas rregullave.

3. Cilado qoftë zgjedhja e zbatuar, interesi i personave që kanë mbulim të shpenzimeve ligjore konsiderohet i garantuar barasvlershmërisht sipas kësaj direktive.

Neni 4

1. Çdo kontratë për sigurimin e shpenzimeve ligjore njihet shprehimisht që:

(a) nëse mund të merret një avokat ose një person tjetër i kualifikuar sipas rregullave të legjislacionit kombëtar me qëllim që të mbrohen, përfaqësohen ose ushtrohen interesat e personit të siguruar në një proces administrativ ose gjyqësor, personi i siguruar është i lirë të zgjedhë këtë avokat apo person tjetër;

(b) personi i siguruar është i lirë të zgjedhë një avokat ose, nëse ai preferon dhe për aq sa lejohet nga legjislacioni kombëtar, një person tjetër të kualifikuar sipas rregullave, të përfaqësojë interesat e tij kurdoherë që lind një konflikt interesash.

2. Me avokat kuptohet çdo person që ka të drejtë të ushtrojë veprimtari profesionale sipas njërës prej emërtimeve të parashikuara në Direktivën e Këshillit 77/249/KEE, datë 22 mars 1977, për mundësimin e ushtrimit të efektshëm nga avokatët e lirisë për të ofruar shërbime [6].

Neni 5

1. Çdo Shtet Anëtar mund të parashikojë përjashtimin nga zbatimi i nenit 4 pika 1 të sigurimit të shpenzimeve ligjore nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) sigurimi është vetëm për çështjet që rrjedhin nga përdorimi i mjeteve rrugore në territorin e Shtetit Anëtar përkatës;

(b) sigurimi lidhet me një kontratë për dhënien e ndihmës në rastin e një aksidenti ose avarie në lidhje me një mjet rrugor;

(c) as siguruesi i shpenzimeve ligjore dhe as siguruesi i ndihmës nuk ofron asnjë klasë të sigurimeve të detyrueshme;

(d) merren masa që këshillimi dhe përfaqësimi ligjor i secilës palë në mosmarrëveshje të kryhet nga avokatë tërësisht të pavarur nëse këto palë janë të siguruara për shpenzimet ligjore nga i njëjti sigurues.

2. Përjashtimi që miraton Shteti Anëtar për një ndërmarrje në përputhje me pikën 1 nuk e cenon zbatimin e nenit 3 pika 2.

Neni 6

Shtetet Anëtare miratojnë të gjitha masat e përshtatshme për të siguar që, pa cenuar të drejtën e ankimit tek një organ gjyqësor që mund të parashikohet nga legjislacioni kombëtar, të parashikohet një procedurë arbitrazhi ose një procedurë tjetër që ofron garanci të ngjashme objektiviteti ku, në rastin e mospërputhjes së mendimit ndërmjet siguruesit të shpenzimeve

ligjore dhe të siguruarit, të mund të merret një vendim mbi qëndrimin që duhet të zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Kontrata e sigurimit duhet të përmendë të drejtën e personit të siguruar për të përdorur një procedurë të tillë.

Neni 7

Nëse lind një konflikt interesash apo nëse ka mungesë mirëkuptimi në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes, siguruesi i shpenzimeve ligjore ose, sipas rastit, zyra e shlyerjes së kërkesave për dëmshpërblim njofton personin e siguruar për:

- të drejtën e përmendur në nenin 4,
- mundësinë e ushtrimit të procedurës së parashikuar në nenin 6.

Neni 8

Shtetet Anëtare shfuqizojnë të gjitha dispozitat që i ndalojnë siguruesit ofrimin njëkohësisht të sigurimit të shpenzimeve ligjore dhe të klasave të tjera të sigurimeve brenda territorit të tij.

Neni 9

Paragrafi i dytë i pikës C të Shtojcës së Direktivës 73/239/KEE zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"Megjithatë, risqet e përfshira në klasat 14, 15 dhe 17 të pikës A nuk mund të konsiderohen si risqe ndihmëse për klasat e tjera.

Megjithatë, risku i përfshirë në klasën 17 (sigurimi i shpenzimeve ligjore) mund të konsiderohet si një risk ndihmës të klasës 18 nëse përmbushen kushtet e parashikuara në paragrafin e parë, ku risku kryesor ka të bëjë vetëm me ndihmën e dhënë për personat që hasin vështirësi gjatë udhëtimit, kur janë larg banesës ose larg vendqëndrimit të përhershëm.

Sigurimi i shpenzimeve ligjore konsiderohet gjithashtu si një risk ndihmës sipas kushteve të parashikuara në nënparagrafin e parë nëse ai ka të bëjë me mosmarrëveshje ose risqe që rrjedhin nga përdorimi i mjeteve lundruese detare ose në lidhje me përdorimin e mjeteve lundruese detare".

Neni 10

Shtetet Anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme për ta zbatuar këtë direktivë brenda datës 1 janar 1990. Shtetet Anëtare njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.

Ata i zbatojnë këto masa jo më vonë se data 1 korrik 1990.

Neni 11

Pas njoftimit [7] të kësaj direktive, Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave kryesore të legjislacionit kombëtar që miratojnë në fushën e rregulluar nga kjo direktivë.

Neni 12

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Luksemburg, më 22 qershor 1987.

Për Këshillin

Presidenti

L. TINDEMANS

[1] GZ nr. C 198, 7. 8. 1979, fq. 2.

[2] GZ nr. C 260, 12. 10. 1981, fq. 78.

[3] GZ nr. C 348, 31. 12. 1980, fq. 22.

[4] GZ nr. L 228, 16. 8. 1973, fq. 3.

[5] Shih faqen 72 të kësaj Gazete Zyrtare.

[6] GZ nr. L 78, 26. 3. 1977, fq. 17.

[7] Kjo direktivë u është njoftuar Shteteve Anëtare, më 25 qershor 1987.